



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Hanit të Elezit
Opština Hani Elezit
Municipal Hani Elezit

Në bazë të nenit 6,7,19.2 dhe 41 të Ligjit mbi transportin rrugor Nr.2004/1, neni 17 pika (f)e Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale dhe neni 6 pika (o) e Statutit të Komunës,Ligjit mbi të Hyrat Vetanake të Komunave, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e radhës të mbajtur më ___/___/2009, pasi shqyrtoi, miraton:

RREGULLOREN PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E HANIT TË ELEZIT

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet ushtrimi i veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallërave në territorin e Komunës së Hanit të Elezit.

Neni 2

Rregullimin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallërave në territorin e Komunës së Hanit të Elezit e bënë Komisioni profesional i trafikut rrugor.

Neni 3

Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave përcakton me aktvendim:

- a.) relacionin e udhëtimit në rrugët e caktuara,
- b.) stacionet dhe vijat lokale për marrjen dhe zbritjen e udhëtarëve,
- c.) krijimin dhe mbajtjen e regjistrave të udhëtimit për inspektimin e tyre,
- d.) transportimi i bagazhit të udhëtarëve,
- e.) vendosjen e shenjave të komunikacionit,
- f.) dizajnin e brendshëm dhe të jashtëm të autobusëve publik,
- g.) stacionet lokale (vendqëndrimet e autobusëve dhe të taxive)
- h.) kushtet për vendosjen e reklamave dhe firmave.

Neni 4

4.1 Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallërave kryhet në bazë të licencës ,përkatësisht lejes së punë.

4.2 Leja e punës për operatorët e transportit me autobus të cilët kryejnë transport urban dhe urban - periferik vlenë një (01) vit, me mundësi të vazhdimit.

4.3 Leja për operator taxi dhe autotaksi vlenë një (01) vit, me mundësi të vazhdimit.

4.4 Leja për operatorët e automjeteve të udhëtarëve 8+1 ulëse vlenë një (01) vit.

4.5 Leja e punës për autobus mund të jepet në qoftë se aplikuesi i plotëson këto kushte:

a.) të ketë në pronësi së paku dy (2) autobusë;

b.) të ketë të punësuar së paku: një (1) vozitës profesionist të kategorisë "D", (01) mekanik për mirëmbajtje, rrespektivisht të ketë kontratë me servisën për Mirëmbajtjen e autobusëve;

c.) të ketë biznesin e regjistruar në MTI;

d.) të ketë selin e kompanisë në territorin e komunës dhe

e.) të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë.

TRANSPORTI RRUGOR I UDHËTARËVE

Neni 5

5.1. Transporti i rregullt me autobus kryhet në relacione të caktuara (linja) , sipas rendit të udhëtimit të përcaktuar dhe të vërtetuar më parë , çmimit të caktuar e të shpallur dhe kushteve tjera të transportit.

5.2. Linjat të cilat lidhin dy e më tepër vendbanime në territorin e Komunës janë linja komunale.

Neni 6

6.1. Komisioni profesional për trafikun rrugor përpilon Planin e linjave urbane dhe urbano-periferik, si dhe numrin e orareve në to.

Rrjetin e linjave komunale dhe urbane periferike e përbëjnë:

Hani Elezit	Gurancë	
Hani Elezit	Krivenik	

6.2. Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave sipas nevojës së qytetarëve dhe kërkesave të operatorëve të transportit publik, mund të formoj edhe linja të tjera të reja.

6.3 Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave sipas nevojës së qytetarëve për ato vendbanime ku nuk ka mundësi të ofrimit të shërbimeve për transport publik qytetarëve me autobus , apo operatorët e autobusëve nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për transportimin e udhëtarëve , mund të lëshojë leje pune edhe operatorëve të automjeteve me 8+1 ulëse.

6.4 Komuna mund të inicioi lidhje të marrëveshjes me komunat tjera për rregullimin reciprok të transportit publik të udhëtarëve, e cila marrëveshje bëhet e plotëfuqishme pas aprovimit nga Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit.

Neni 7

7.1. Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave do të revokoi rendin e udhëtimit operatorit, nëse:

- a.) në afat prej tre (3) ditësh nga dita e fuqizimit nuk e fillon ushtrimin e Veprimtarisë;
- b.) brenda një (1) muaji kalendarik nuk bënë nisje më së paku tre (3) herë pa miratimin e drejtorisë kompetente të komunës;
- c.) bënë ndërprerje të kohëpaskohshme të mbajtjes së nisjes, respektivisht kur 12 herë brenda afatit të zgjatjes së rendit të udhëtimit nuk mban nisjen pa miratimin e drejtorisë;

7.2. Linjat dhe nisjet e revokuara do të konsiderohen si të lira dhe të njëjtat i nënshtrohen procedurës për ndarjen e tyre.

7.3. Vendimet i merrë drejtoria që e ka vërtetuar at pas dëshmisë së inspektorit të trafikut rrugor të Kuvendit Komunal.

7.4. Operatori i transportit është i obliguar që ndryshimin e rendit të udhëtimit dhe të drejtimit të transportit, ndaljen e përkohëshme apo të përhershme të transportit në linjën e lejuar, ta shpallë përmes shtypit apo një mjeti tjetër të informimit.

7.5. Në rast se operatori është i detyruar që të ndërprejë ushtrimin e veprimtarisë, është i obliguar që në afat prej 24 orëve të njoftojë drejtorinë e cila e ka vërtetuar rendin e udhëtimit.

Neni 8

8.1. Të gjithë autobusët me të cilët kryhet transporti publik urban dhe urbano-periferik i udhëtarëve, duhet të jenë të regjistruar dhe teknikisht në rregull sipas dispozitave ligjore.

8.2. Autobusi me të cilin kryhet transporti publik urban duhet të ketë:

- në pjesën anësore të ekspozoi firmën, respektivisht emërtimin e transportuesi;
- në këndin e poshtëm të djathtë të xhamit mbrojtës numrin e linjës me kohën e nisjes dhe kohën e arritjes ose intervalin e lëvizjes në stacionin e fundit;
- orarin e udhëtimit dhe çmimoren e transportit ta vendos në vend të dukshëm dhe mbishkrimin për ndalimin e pirjes së duhanit;

8.3. Autobusi duhet të plotësojë të gjitha kushtet higjieno-teknike të përcaktuara me ligj.

8.4. Kur autobusi nuk kryen transportin e rregullt të udhëtarëve gjatë lëvizjes së tij duhet që në këndin e majtë të xhamit mbrojtës vendoset mbishkrimi përkatës "Garazh" apo "Defekt";

8.5. Në sezonin e dimrit autobusi, para daljes në mbajtje të linjës, duhet të ngrohet.

Neni 9

Transporti publik urban i udhëtarëve në komunikacionin linjor kryhet me linja të përhershme, me të cilat transporti kryhet për çdo ditë dhe gjatë tërë vitit apo në periudhë të caktuar të vitit.

Neni 10

10.1 Linjat e përhershme të transportit publik urban dhe urbano-periferik të udhëtarëve rregullohen në përputhje me Planin operativ të transportit publik lokal.

10.2. Koha mbrojtës e operatorëve për çdo nisje të jetë së paku një (30) minuta.

10.2 Të gjitha linjat (rendet e udhëtimit) për transport publik urban të udhëtarëve vlejné një (1) vit, me mundësi të vazhdimit.

Neni 11

- 11.1. Hyrja dhe dalja e udhëtarëve bëhet vetëm në stacionet e autobusëve dhe vend ndaljet të destinuara dhe të regjistruara në rendin e udhëtimit.
- 11.2. Operatori është i obliguar të ndalet në të gjitha vend ndaljet të cilat i ka të regjistruara në rendin e udhëtimit.

Neni 12

- 12.1. Çdo automjet në transportin rrugor të udhëtarëve në komunikacionin urban dhe urbano-periferik duhet të jetë i pajisur me aparat zjarrëfikës funksional, me barnatore manuele dhe me çekan për thyerjen e xhamit.
- 12.2. Në pjesën e brendshme të automjeteve duhet të vendosen mbishkrimet e rëndësishme për rendin në automjet, ulëset për kategorit e veçanta të udhëtarëve, shenjat e dyerve të hyrjes dhe daljes.
- 12.3. Ndalohet vendosja në automjetet e transportit publik rrugor të udhëtarëve e fotografive dhe objekteve të tjera me karakter pornografik, reklamat që shprehin pikëpamjet politike, fetare, racore, gjinore dhe të gjitha ato që cenojnë ndjenjat e të tjerëve.

Neni 13

- 13.1. Sinjalin për nisjen dhe ndaljen e automjetit e jep personeli i automjetit.
- 13.2. Vetëm personeli i automjetit hapë dhe mbyllë dyert e automjetit.
- 13.3. Personeli i automjetit nuk guxon të japë shenjë për nisje deri sa të konstatojë se janë mbyllur dyert për hyrje dhe për dalje të udhëtarëve.

Neni 14

Personeli i automjetit ka për detyrë që gjatë orarit të punës të mbaj rrobat (uniformëm) zyrtare dhe ndaj udhëtarëve të ketë sjellje korekte.

Neni 15

- 15.1. Udhëtarët hyjnë në automjet në dyert e shënuara për hyrje dhe zbresin në dyert e shënuara për dalje.
- 15.2. Personat me aftësi të kufizuara fizike, gratë shtatëzana, personat me fëmijë deri në 5 vjeç, inspektorët e trafikut, policët në uniformë dhe personat me autorizime të veçanta mund të hyjnë edhe në dyert e daljes.

Neni 16

- 16.1. Udhëtari mund të bartë me vehte në automjet bagazhin e dorës deri në 25 kg, karrocën e mbledhur të fëmijëve, pushkën e gjuetis ose të sportit me këllëfë, skitë dhe kompletin për peshkim.
- 16.2. Në automjet mund të vendosen në pjesën ndihmëse dhe me shportë në kokë (turi), qenët zyrtarë dhe qenët ciceron të personave të verbër.

Neni 17

NDALOHET :

1. të pengohet personeli i automjetit në kryerjen e detyrës;
2. pirja e duhanit në automjet;
3. vendosja e kafshëve dhe e shpezëve në automjet, përveç në raste nga neni 16.2. i kësajë rregullore;
4. hyrja në automjet me armë zjarri - kjo ndalesë nuk ka të bëjë me personat e autorizuar për bartjen e armëve;
5. bartja në automjet e sendeve të cilat mund të lëndojnë, dëmtojnë, ndotin, shqetësojnë udhëtarët ose dëmtojnë automjetin e transportit publik;
6. bartja në automjet e materialeve ndezëse, brejtëse dhe e mjeteve eksplozive;
7. hyrja në automjet në gjendje të dehur;
8. shqetësimi i udhëtarëve me këndim, me muzikë, me britmë, me shprehje e sjellje të papërshtatëshme;
9. hedhja e mbeturirave dhe pështymja në automjet;

TRANSPORTI TAKSI

Neni 18

18.1 Transporti Taksi është transporti publik i personave në transportin jo të rregullt (jashtë linjor) rrugor për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është që më parë i njohur dhe përcaktohet në bazë të taksimetrit sipas çmimorese së shërbimeve.

18.2 Çmimorja duhet të jetë e vërtetuar nga drejtoria kompetente për komunikacion, e vendosur në vend të dukshëm Brenda automjetit.

18.3 Taksimetri duhet të jetë në gjendje të rregullt, i atestuar dhe vulosur sipas kushteve të përcaktuara për taksimetër si dhe i vendosur në vend të dukshëm në automjet.

18.4 Transportuesi që kryen transport taksi të udhëtarve është i obliguar që me kërkesën e udhëtarit t'i jep atij dëshminë për shërbimin e kryer, e cila dëshmi përmban: regjistrimin e automjetit, kohën e transportit, çmimin dhe nënshkrimin.

18.5 Transportuesi taksi është i obliguar që udhëtarin ta transportojë në relacionin sa më të shkurtër të mundshëm.

18.6 Kur automjeti taksi nuk është në lëvizje, vozitësi është i obliguar të qëndrojë në automjet ose pran tijë.

Neni 19

19.1 Transporti taksi mund të kryhet vetëm me automjete pesë (5) ose (4+1) ulëse dhe i cili i ka së paku pesë (5) dyerë.

19.2 Automjeti sipas paragrafit 19.1 të këtij neni nuk mund të ketë mjet shtesë për bartje (rimorkio).

Neni 20

Drejtoria e Urbanizmit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave me vendim të veçantë do të përcaktojnë, numrin dhe vendet e stacioneve për taksi, mënyrën e shfrytëzimit të tyre, rregullimin si dhe numrin e automjeteve në stacionet taksi.

Neni 21

Automjeti për transport taksi , përveç kushteve tjera të përcaktuara me ligj, duhet t'i plotësoi edhe këto kushte:

- a) të ketë pesë (05) dyerë;
- b) të ketë (4+1) ulëse;
- c) të ketë taksimetri;
- d) të ketë të vendosur firmën "TAXI" në pjesën e përparme të kulmit të Automjetit, e cila duhet të ndriçojë natë;

OPERATORI TAKSI

Neni 22

22.1 Operator taksi për marrjen e lejes së punës(licencës) duhet t'i plotësojë këto kushte:

- a) të ketë selin në territorin e komunës së Hanit të Elezit;
- b) të ketë çertifikatën për regjistrimin e biznesit;
- c) të ketë më së paku tre (03) automjete në pronësi;
- d) të gjithë vozitësit e punësuar të posedojnë patentë shoferin më të vjetër se dy (02) vite;
- e) të ketë vendparking, frekuenca, zyre, lidhje telefonike dhe servisn për mirëmbajtje të sigurt të automjeteve;

22.2 Për çdo ndryshim në automjete dhe drejtues të tijë , operatori taksi është i obliguar që ta njoftojë organin i cili ka lëshuar licencën – lejën e punës.

AUTOTAKSI

Neni 23

Për marrjen e lejes së punës (licencës) për auto taksi aplikuesi duhet t'i plotësoj këto kushte:

- a) të jetë banor i komunës së Hanit të Elezit;
- b) të posedojë patent shoferin më të vjetër se dy (02) vite;
- c) të ketë çertifikatën e regjistrimit të biznesit;
- d) të ketë në pronësi automjetin të cilin e drejton;
- e) të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë;

SHFUQIZIMI I LEJËS SË PUNËS (LICENCËS)

Neni 24

Leja e punës (licenca) shfuqizohet:

- a) me kërkesën e titullarit të sajë;
- b) me skadimin e afatit;
- c) nëse vdes titullari apo humb aftësinë për vozitje;

- d) nëse titullari kryen tri (03) kundërvajtje në komunikacion gjatë vitit kalendarik;
- e) kur humbet ndonjëra nga kushtet e parapara me ligj dhe me këtë Rregullore për marrjen e lejes (licencës);

Neni 25

25.1 Procedurën për shfuqizimin apo revokimin e lejes së punës (licencës) e inicon inspektori komunal i trafikut, inspektori i trafikut nga ministria kompetente apo personi tjetër i autorizuar nga ministria ose komuna.

25.2 Vendimi për shfuqizimin apo revokimin e lejes e merr organi që ka lëshuar lejen e punës - licencën.

Neni 26

26.1 Për lëshuarjen e lejes së punës (licencës) për operator TAKSI dhe AUTO TAKSI

Aplikuesi duhet të paguaj:

- | | |
|---------------------------------------|------|
| - për operator me autobusë | 50 € |
| - për vërtetim të rendit të udhëtimit | 25 € |
| - për operator TAKSI | 50 € |
| - për auto taxi | 25 € |

26.2 Për transport me automjete (8+1) ulëse aplikuesi duhet të paguaj:

- a) për leje të punës njiveqare (vjetore) 30 €
- b) për vërtetim të rendit të udhëtimit 15 €

TRANSPORTI RRUGOR I MALLËRAVE

Neni 27

27.1 Transporti rrugor i mallërave kryhet si:

- a) transport i mallërave për nevoja personale; dhe
- b) transport i mallërave me qira dhe pagesë,

27.2 Gjatë transportit të mallërave, operatori në automjet duhet të posedojë këto dokumente:

- a) lejen e punës (licencën);
- b) fletëngarkesën;

Neni 28

28.1 Nga Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Bujqësisë, mund të merret leja e punës (licenca) për transportin publik të mallërave vetëm për ato automjete kapaciteti i të cilave nuk e tejkalon peshën e ngarkesës mbi 12 tonë.

28.2 Për marrjen e lejes së punës (licencës) për transport publik të mallërave me automjet, kapaciteti i të cilit nuk tejkalon peshën e ngarkesës mbi 12 tonë, aplikuesi duhet t'i plotësoj këto kushte:

- a) të jetë banor i komunës së Hanit të Elezit;
- b) të ketë çertifikatën e regjistrimit të biznesit;
- c) të ketë mesë paku një (01) automjet transportues;
- d) të ketë të shkruar në dyert e kabinës të automjetit emrin e transportuesit

dhe selinë e tijë;

e) të ketë së paku dy (02) vite patent shoferin e kategorisë përkatëse;

f) të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë për transport Publik të mallërave;

28.3 Për marrjen e lejes së punës (licencës) nga paragrafi 28.2 të këtijë neni, Aplikuesi duhet të paguaj 30 €.

MBIKËQYRJA

Neni 29

29.1 Mbikqyrjen në transportin rrugor urban dhe urbano-periferik si dhe transportin taksi brenda territorit të komunës e kryenë Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Bujqësisë, përkatësisht Inspektori i trafikut dhe Policia e Kosovës - PK.

29.2 Inspektori i trafikut rrugor është i autorizuar të:

1. bëjë inspektimin e operatorëve të transportit rrugor se a janë duke ushtruar veprimtarin e vet në pajtim me dispozitat e ligjit dhe të kësajë rregulloreje dhe akteve tjera të KK , në bazë të lejeve të punës (licencave), të vërtetoi identitetin e operatorit transportues, personelit vozitës dhe personave të tjerë përgjegjës për kryerjen e transportit;
2. urdhërojë menjanimin dhe evitimin e lëshimeve dhe mangësive për plotësimin e kushteve të përcaktuara me ligj dhe këtë rregullore , për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe të mallërave;
3. përjashton nga qarkullimi automjetin me të cilin kryhet transporti në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të kësajë rregulloreje, cakton vend-parkimin merr lejen e qarkullimit dhe targat në kohëzgjatje prej 48 orësh;

29.3 Nëse të njejtit operator të transportit i shqiptohet masa e denimit për herë të dytë për shkaqet e përcaktuara në paragrafin 4.1 dhe 4.2 të këtij neni, automjeti do të përjashtohet nga qarkullimi në kohëzgjatje deri pesë (05) ditë. 29.4 Me rastin e përjashtimit të automjetit taksi , merret shenja "TAXI" dhe numri i evidencës dhe i regjistrimit të qarkullimit.

29.5 Me kalimin e afatit të shqiptimit të denimit nga paragrafi 4.1 dhe 4.2 të këtij neni, inspektori i këthen operatorit dokumentet dhe targat e marra qoftë vetë apo përmesë organit i cili ka lëshuar të njejtat.

Neni 30

Kur inspektori përjashton automjetin nga qarkullimi, merr vendim që automjeti i ndaluar të dërgohet me shpenzime të mbajtësit të licencës, lejes së punës në vend të caktuar për këto raste.

Neni 31

31.1 Kundër vendimit të inspektorit komunal për trafik rrugor mund të ushtrohet ankesë ministrisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

31.2 Ankesa dërgohet përmes organit komunal kompetent për komunikacion.

31.3 Ankesa nuk e ngadalson zbatimin e vendimit.

DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 32

Për kundërvajtje do të dënohen me gjobë prej 100 deri 500 € operatori i transportit publik të udhëtarëve në rast se:

- a) ushtron veprimtarin e transportit publik urban dhe urbano- periferik,veprimtarin pa licencë , leje pune (neni 4.2);
- b) vepron në kundërshtim me nenin (5.1, 27.2);
- c) Për kundërvajtjet nga alinea paraprake mund të denohet me gjobë prej 50 deri 300 € edhe person i përgjegjës në personin juridik.

Neni 33

Për kundërvajtje do të dënohet me gjobë prej 50 deri në 500 € , transportuesi në rast se:

a) vepron në kundërshtim me nenin (4.3;8.2;8.4;8.5;10.2.;22.2) të kësajë rregullore; Për kundërvajtjet nga alinea paraprake mund të denohet me gjobë prej 50 deri 300 € edhe personi përgjegjës në personin njuridik.

Neni 34

Për kundërvajtje do të denohet me gjobë prej 50 deri 150 € , transportuesi në rast se: vepron në kundërshtim me nenin (11.1,11.2,12.2,12.3,14,17 nga alinea 1 deri në alinen 9,18.2,18.3,18.4,18.6,19.2, të kësajë Rregullore.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 35

Të gjithë operatorët e transportit publik dhe pronarët e automjeteve (8+1) të cilët posedojnë leje të punës (licencë) në afat prej 6 muajsh apo leje të përkohshme, obligohen që afat prej prej ditës së hyrjes në fuqi të kësajë rregulloreje , t'i harmonizojnë lejet për ushtrimin e veprimtarive të tyre me dispozitat e kësajë rregulloreje.

Neni 36

Për të gjitha rastet që nuk janë përfshirë me këte rregulloreje , do të zbatohen dispozitat e ligjit për transport rrugor nr. 2004/01.

Neni 37

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Hani i Elezit

Shaban Çupi

Nr. ___ / ___ 2009

Kryesuesi i Kuvendit

Data: ___ / ___ 2009